



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 103 datë 04.11 2025

**PËR**

**MIRATIMIN E SASISË SË KARBURANTIT TË AUTOMJETEVE, TË NAFTËS GAZIT  
TË LENGHEM PËR NGROHJE TË KOPSHTEVE TË BASHKISË PËRMET DHE  
NJËSIVE ADMINISTRATIVE, PËR AUTOMJETET MZSH, AUTOMJETET E  
NDËRMARRJES SË PASTRIM GJELBËRIMIT, LËVIZJEN E PUNONJËSVE TË  
SHËRBIMIT PYJOR, PËR MJETET E BORDIT TË KULLIMIT DHE MJETET E  
PUNËS PËR RRUGËT RRURALE.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 04/12/2025, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

**VENDOSI:**

1. Sasia e harxhimit të karburantit për automjetin e administrates, Policisë Bashkiake, automjetet e NJA etj, të jetë 15000 litra në vit.
2. Sasia e harxhimit të karburantit për automjetet e Ndërmarrjes së Pastrim Gjellbërimit të jetë 23500 litra në vit.
3. Sasia e harxhimit të karburantit për Automjetet e MZSH, të jetë 4500 litra në vit.
4. Sasia e harxhimit të karburantit për Emergjencat Civile, të jetë 2000 litra në vit.
5. Sasia e harxhimit të karburantit për lëvizjen e punonjësve të shërbimit pyjor të jetë 1800 litra në vit.
6. Sasia e harxhimit të karburantit për mjetet e Bordit të Kullimit të jetë 12000 litra në vit.



7. Sasia e harxhimit të karburantit për mjetet e punës për Rrugët Rrurale të jetë 13000 litra në vit.
8. Sasia e harxhimit të naftës për kaldajën e Kopshtit Nr.2 të jetë 3200 litra për sezonin 1 Janar - 15 Mars 2026 dhe 15 Nentor - 31 Dhjetor 2026.
9. Sasia e harxhimit të gazit të lëngshëm për kaldajën e shkollës Meleq Gosnishti të jetë 9600 litra për sezonin 15 Nentor - 31 Dhjetor 2026 - 1 Janar - 15 Mars 2027.
10. Për institucionet dhe Nj.Administrative në varësi të Bashkisë të cilat nuk kanë në inventarin e tyre të mjeteve themelore automjete , autorizohet Kryetari i Bashkisë, të lidh kontrata, me mjete private të punonjësve të këtyre institucioneve.
11. Sasi e karburantit për automjetin "Bibloteka lëvizës" të jetë 250 litra në vit.
12. Sasi e karburantit për automjetin "Kamionçinë" tip GAZ të jetë 1000 litra në vit.
13. Shpenzimet do të përballohen nga buxheti i vitit 2026.
14. Për zbatimin e këtij vendimin garkohet Drejtoria e Financë Buxhetit Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese.
15. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar) dhe i shtrin efektet financiare nga data 01.01.2026 – 31.12.2026.

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**  
**Aleks TANE**

**KRYETAR**  
**Anila DHIMITRI**